**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE**
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

# <u>SKELETKURRIKULI</u>

## Për Profilin Mësimor

# MURATIM DHE SUVATIM

## Niveli III i KSHK

**(1 vjeçar)**

## (Në drejtimin mësimor "Ndërtim")

**Kodi: B1-III-22**

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2022**

## Përmbajtja:


**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Ndërtim”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK.

**III. Plani mësimor për profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Ndërtim”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Ndërtim”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet e muratimit dhe të suvatimit, në fushën e ndërtimit.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Muratim dhe suvatim” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Muratim dhe suvatim”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

**3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin e II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një bisnesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të planifikojë dhe të kryejë organizimin e vogël të punës në punimet e muratimit dhe suvatimit.
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit përkatës.
- Të parapërgatisë veglat, instrumentet, mjetet dhe vendin e punës.
- Të kryej matje dhe shënime duke përdorur instrumenta matës dhe niveluese.
- Të ndërtojë mure me tulla të ndryshme në lidhje "L", " T" dhe " +".
- Të ndërtojë mure me tulla të detajeve të ndryshme (kanalet e ventilimit/tymit, pilastra, patura, shtylla).
- Të ndërtojë mure me tulla me shtresë termoizoluese.
- Të ndërtojë mure me blloqe të ndryshme (betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.)
- Të ndërtojë mure me tulla xhami.
- Të ndërtojë mure dekorativë dhe qemerë me tulla.
- Të ndërtojë mure mbajtëse e pritëse me gurë në rrugë. .
- Të ndërtojë me mur tulle puseta për ujësjellsa – kanalizime.
- Të ndërtojë mure me gurë, xokol e në lartësi dhe buto-betoni.
- Të ndërtojë mure me gurë në të thatë dhe gabiona.
- Të suvatojë sipërfaqe të brendshme e të jashtme si: tavane, mure, kënde të mureve dhe shpatulla të dyer-dritareve.
- Të kryejë suvatime të ndryshme dekorative.
- Të kryejë riparime në punimet e muratimit dhe suvatimit.
- Të përdorë, mirëmbajë dhe sistemojë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të komunikojë me etike profesionale.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve të kryera.
- Të marrë masa për shërbimin e mbrojtjes nga zjarrit dhe shpëtimit në vendin e punës.
- Të sigurojë higjenën personale në punë dhe të mbajë pastër vendin dhe veglat e punës.

- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit.
- Të ngrejë nivelin tekniko – profesional me anë të trajnimeve për teknologji të reja për profesionin.
- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të përdorë teknologjinë dixhitale në mbështetje të veprimtarisë profesionale.

**4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në ndërmarrje ndërtimi shtetërore/private, për t'u vetëpunësuar si individ i lirë ose mbas një përvoje pune krijon një biznes të vogël në punimet e muratimit dhe suvatimit, si dhe të punësojë të tjerë në të.
Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin "Ndërtim", për të fituar diplomën e "Maturës shtetërore profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK

| Plani mësimor për profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK (1 vjeçar) | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ vjetore** |
| | | | **Klasa 12** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **8/9** (272/306) |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 |
| 3 | | Gjuhë e huaj e parë | 2 |
| 4 | | Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë) | (1) |
| 5 | | Matematikë | 2 |
| 6 | | TIK | 1 |
| 7 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **7** (238) |
| 1 | L-17-157-22 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-01-158-22 | Vizatimet e ndërtimit | 1 |
| 3 | L-02-159-22 | Teknologji muratimi dhe suvatimi | 2 |
| 4 | L-02-160-18 | Teknologji konstruksionesh mbajtëse | 1 |
| 5 | L-02-591-22 | Teknologji e ndërtimit të mureve mbajtëse, pritëse dhe rrjetit ujësjellës-kanalizim në rrugë e trotuare | 1 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** | **12** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | (Gjithsej) | (408) |
| 1 | M-02-1819-22 | Ndërtimi i mureve me tulla të ndryshme | 102 |
| 2 | M-02-1820-22 | Termoizolimi i mureve | 69 |
| 3 | M-02-1821-22 | Ndërtimi i mureve me gurë dhe buto-beton | 84 |
| 4 | M-02-1822-22 | Suvatime të brendshme e të jashtme | 102 |
| 5 | M-02-1823-22 | Ndërtimi i mureve me gurë në të thatë | 51 |
| **D.** | | **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar** (Gjithsej) | **3** (102) |
| 1 | M-02-1824-22 | Ndërtimi i mureve dekorativë | 51 |
| 2 | M-02-1825-22 | Ndërtimi i mureve mbajtëse në rrugë | 51 |
| 3 | M-02-1826-22 | Ndërtimi i qemerëve me tulla | 51 |
| 4 | M-02-1827-22 | Suvatimet dekorative | 51 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31** (1020/ 1054) |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).
Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në profilin "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja

e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i "të nxënit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional "Muratim dhe suvatim".

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet çertifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

## VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor "Muratim dhe suvatim", niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Bazat e sipërmarrjes" (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontektin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontektin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efiçiencë burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 – 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 2** | Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse | 3 orë |
| **Tema 3** | Vetvlerësimi i potencialit personal | 3 orë |
| **Tema 4** | Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive | 3 orë |
| **Tema 5** | Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja | 4 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 6** | Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve | 3 orë |
| **Tema 7** | Etika e komunikimit dhe negocimit | 3 orë |
| **Tema 8** | Puna individuale dhe puna në grup | 4 orë |
| **Tema 9** | Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi | 3 orë |
| **Tema 10** | Përgjegjësia individuale dhe shoqërore | 3 orë |
| **Tema 11** | Menaxhimi efiçient i burimeve | 3 orë |
| **Tema 12** | Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 13** | Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale | 4 orë |
| **Tema 14** | Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale | 3 orë |
| **Tema 15** | Format e organizimit të sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 16** | Konteksti i sipërmarrjeve | 6 orë |
| **Tema 17** | Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve | 4 orë |
| **Tema 18** | Marrëdhëniet e punës | 4 orë |
| **Tema 19** | Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës | 4 orë |

## 2. Lënda “Vizatimet e ndërtimit” (L-01-158-22). Kl. 12 - 34 orë

- **Synimet e lëndës “Vizatimet e ndërtimit”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatimet e ndërtimit”, klasa 12, nxënësit duhet:

– Të interpretojnë fletët e vizatimeve të ndërtimit.
– Të dallojnë shenjat konvencionale që përdoren në fletët e vizatimeve të ndërtimit.
– Të vizatojnë shenjat konvencionale që përdoren në fletët e vizatimeve të ndërtimit sipas legjendës së dhënë.
– Të përshkruajnë vizatimet e ndërtimit që përbëjnë fletët arkitektonike të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë.
– Të përshkruajnë vizatimet e ndërtimit që përbëjnë fletët konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë.
– Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së bodrumit dhe kateve.
– Të vizatojnë planimetritë e bodrumit dhe kateve të ndërtesës sipas skicës së dhënë.
– Të përshkruajnë fazat e vizatimit të prerjeve të ndërtesës.
– Të vizatojnë prerjet kryesore të ndërtesës sipas skicës së dhënë.
– Të përshkruajnë fazat e vizatimit të pamjeve.
– Të vizatojnë pamjet kryesore të ndërtesës sipas skicës së dhënë.
– Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planit të themeleve dhe prerjeve të tyre.
– Të vizatojnë planin e themeleve të ndërtesës dhe prerjet e tyre sipas skicës së dhënë.
– Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planit të strukturave të ndërkateve.
– Të vizatojnë planin e strukturave të ndërkateve të ndërtesës sipas skicës së dhënë.
– Të përshkruajnë fazat e vizatimit të detajeve arkitektonike dhe konstruktive të ndërtesës.
– Të vizatojnë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas skicës së dhënë.

- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për të gjitha llojet e muraturave e me materiale të ndryshme.
- Të interpretojnë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje për objekte të ndryshme ndërtimi.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Vizatimet e ndërtimit", kl. 12- 34 orë:**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Vizatimet e ndërtimit | 2 orë |
| **Tema 2** | Shenjat dalluese në vizatimet e ndërtimit | 2 orë |
| **Tema 3** | Planimetritë e bodrumit dhe kateve, vizatimi i tyre | 5 orë |
| **Tema 4** | Planimetria e themeleve, prerjet dhe vizatimi i tyre | 3 orë |
| **Tema 5** | Pamjet kryesore të ndërtesës dhe vizatimi i tyre | 4 orë |
| **Tema 6** | Prerjet kryesore të ndërtesës dhe vizatimi i tyre | 8 orë |
| **Tema 7** | Plani i strukturave të ndërkatit dhe shkallës dhe vizatimi i tyre | 4 orë |
| **Tema 8** | Detajet arkitektonike dhe konstruktive të ndërtesës dhe vizatimi i tyre | 6 orë |

**3. Lënda "Teknologji muratimi dhe suvatimi" (L-02-159-22). Kl. 12 - 68 orë**

- **Synimet e lëndës "Teknologji muratimi dhe suvatimi", kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Teknologji muratimi dhe suvatimi", klasa 12, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për objekte të thjeshta ndërtimi me themele të vazhduara e mure masive.
- Të zbërthejnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për objekte ndërtimi për themele e mure.
- Të skicojnë planimetri dhe prerje për objekte ndërtimi për themele e mure, me përmasa të dhëna.
- Të interpretojnë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje për objekte ndërtimi.
- Të zbërthejnë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje në objekte ndërtimi.
- Të vizatojnë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje në objekte ndërtimi.
- Të përshkruajnë llojet e fugaturave për të gjitha llojet e muraturave me materiale të ndryshme.
- Të përshkruajnë llojet dhe hapat e ndërtimit të mureve me tulla të llojeve të ndryshme, blloqe, gipsi, butobetoni etj.
- Të përcaktojnë llojin dhe hapat e suvatimit të brendshëm në mure dhe tavaneve
- Të përcaktojnë llojin dhe hapat e suvatimit të brendshëm e të jashtëm dekorativ, sipas materialit dhe teknikës së përdorur.
- Të përcaktojnë llojin dhe hapat e suvatimit të jashtëm (fasada).
- Të përshkruajnë llojet dhe hapat e termoizolimit të mureve, sipas materialit dhe teknikës së përdorur.
- Të përcaktojnë llojet dhe hapat e riparimeve të mureve dhe suvatimeve.
- Të përshkruajnë llojet dhe hapat e riparimeve të mureve dhe suvatimeve sipas materialit dhe teknikave të përdorura.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji muratimi dhe suvatimi”, kl.12-68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Skicimi i mureve me materiale të ndryshme dhe detajet e tyre | 8 orë |
| **Tema 2** | Teknologjia e muratimit me gurë dhe buto-beton për themele dhe në lartësi | 8 orë |
| **Tema 3** | Teknologjia e muratimit me gurë në të thatë dhe gabjona | 4 orë |
| **Tema 4** | Teknologjia e muratimit me tulla të ndryshme dhe blloqe | 8 orë |
| **Tema 5** | Teknologjia e muratimit të mureve mbajtëse dhe pritëse në rrugë | 4 orë |
| **Tema 6** | Teknologjia e mureve me tulla me shtresë termoizoluese dhe zëizoluese | 4 orë |
| **Tema 7** | Teknologjia e mureve dekorative | 4 orë |
| **Tema 8** | Teknologjia e muratimit të detajeve të ndryshme arkitektonike | 6 orë |
| **Tema 9** | Teknologjia e suvatimit të brendshëm në tavane dhe mure | 8 orë |
| **Tema 10** | Teknologjia e suvatimit të jashtëm (të fasadave) | 6 orë |
| **Tema 11** | Teknologjia e suvatimeve dekorative | 4 orë |
| **Tema 12** | Teknologjia e riparimit të mureve dhe suvatimeve të llojeve të ndryshme | 4 orë |

**4. Lënda “Teknologji konstruksionesh mbajtëse” (L-02-160-18). Kl. 12 - 34 orë**

- **Synimet e lëndës “ Teknologji konstruksionesh mbajtëse”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji konstruksionesh mbajtëse”, klasa 12, nxënësit duhet:

– Të rendisin llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave sipas skemave konstruktive.
– Të përshkruajnë elementet konstruktive përbërëse të konstruksioneve prej betoni të armuar.
– Të interpretojnë skica konstruktimi të elementeve të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
– Të interpretojnë tabelën e sipërfaqes së armaturës së hekurit (Fa**)** për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
– Të përcaktojnë numrin dhe diametrin (n dhe Ø**)** të shufrave për Fa të dhënë për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar me përmasa të dhëna.
– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllakë monolite prej betoni të armuar.
– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për tra monolit prej betoni të armuar.
– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllakë të përzier me trarë prej betoni të armuar dhe mbushje me tulla me një fushë.
– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për plint monolit prej betoni të armuar të shkallëzuar dhe shtyllë monolite prej betoni të armuar dykatëshe me prerje katrore.
– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për mure monolite prej betoni të armuar.





– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për shtresë prej betoni të armuar nën pllakën e themelit dhe pllakë themeli prej betoni të armuar për ndërtesa të larta.
– Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për shkallë monolite prej betoni të armuar.
– Të hartojnë tabelën e specifikimit të armaturës së hekurit për elementet prej betoni të armuar.
– Të përshkruajnë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruktive prej betoni të armuar monolite.
– Të përshkruajnë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura.
– Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej guri, butobetoni, e tulle.
– Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej druri e metali.

**Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Teknologji konstruksionesh mbajtëse", kl.12 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Konstruksionet mbajtëse dhe elementet konstruktive të tyre | 4 orë |
| **Tema 2** | Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje (pllaka dhe trarë) | 8 orë |
| **Tema 3** | Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në shtypje (shtylla dhe mure) | 4 orë |
| **Tema 4** | Parimet bazë për konstruktimin e themeleve prej betoni të armuar (pllakë, trarë dhe plinta) | 4 orë |
| **Tema 5** | Parimet bazë për konstruktimin e shkallëve prej betoni të armuar | 6 orë |
| **Tema 6** | Konstruksionet prej betoni të armuar të parapërgatitura | 2 orë |
| **Tema 7** | Konstruksionet prej betoni të armuar gjysmë të parapërgatitura | 2 orë |
| **Tema 8** | Konstruksionet prej guri, butobetoni, e tulle | 2 orë |
| **Tema 9** | Konstruksionet prej druri e metali | 2 orë |

## 5. Lënda "Teknologjia e ndërtimit të mureve mbajtëse, pritëse dhe rrjetit ujësjellës-kanalizim në rrugë e trotuare" (L-02-591-22) kl. 12 –34 orë

- **Synimet e lëndës "Teknologjia e ndërtimit të mureve mbajtëse, pritëse dhe rrjetit ujësjellës-kanalizim në rrugë e trotuare", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës " Teknologjia e ndërtimit të mureve mbajtëse, pritëse dhe rrjetit ujësjellës-kanalizim në rrugë e trotuare ", klasa 12, nxënësit duhet:
– Të përshkruajnë ndërtimin e mure mbajtëse e pritëse në rrugë.
– Të përshkruajnë llojet e materialeve të mureve mbajtëse e pritëse në rrugë.
– Të përshkruajnë hapat e ndërtimit të mureve mbajtëse e pritëse në rrugë.
– Të përshkruajnë rrjetin e kanalizimeve në rrugë.
– Të interpretojnë rrjetin e kanalizimit në rrugë dhe pjesët përbërëse të tij.
– Të interpretojnë skicat e pusetave të kanalizimit dhe zgarave të shiut në rrugë .
– Të përshkruajnë rrjetin e ujësjellësit në trotuarë dhe pjesët përbërëse të tij.
– Të interpretojnë skicat e rrjetit e ujësjellësit në trotuarë dhe pjesët përbërëse të tij.
– Të interpretojnë skicat e pusetave të ujesjellësit në trotuarë.
– Të interpretojnë skicat e kaptazheve dhe burimeve të ujit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologjia e ndërtimit të mureve mbajtëse, pritëse dhe rrjetit ujësjellës-kanalizim në rrugë e trotuare”, Kl.12 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Teknologjia e ndërtimit të mureve mbajtëse e pritëse në rrugë | 8 orë |
| **Tema 2** | Teknologjia e ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve në rrugë | 8 orë |
| **Tema 3** | Teknologjia e ndërtimit të pusetave të kanalizimit dhe zgarave të shiut në rrugë | 4 orë |
| **Tema 4** | Teknologjia e ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit në trotuare | 8 orë |
| **Tema 5** | Teknologjia e ndërtimit të pusetave të ujesjellësit në trotuare | 4 orë |
| **Tema 6** | Teknologjia e ndërtimit të burimeve dhe kaptazheve të ujë sjellësit | 2 orë |

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli "Ndërtimi i mureve me tulla të ndryshme"

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **NDËRTIMI I MUREVE ME TULLA TË NDRYSHME** | **M-02-1819-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit në ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme në lidhje në formë "L", " T" dhe " +" ndërtimin e detajeve të mureve me tulla si dhe me tulla xhami e blloqe | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 102 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor "Ndërtim", niveli II i KSHK. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;<br>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet e ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme;<br>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme;<br>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme;<br>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;<br>– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe pajisjet e punës sipas proçeseve përkatëse të punës;<br>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve të ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme;<br>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;<br>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;<br>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera të punës;<br>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë. |

**RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme sipas manualeve të përdorimit;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme;
- të kontrollojnë nivelimin e bazës ku do të ndërtohet muri, duke përdorur instrumentet niveluese;
- të shënojnë kuotat e murit dhe tavanit sipas fletës projektit;
- të përgatisin tullat ½, ¾ etj. sipas llojit të tyre.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit ndërtojnë mur tulle në lidhje në Formë "T" "L" dhe "+" (kryq).**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kryejnë piketimin me spango të mureve në lidhje në formë"T" "L" dhe "+" (kryq);
- të përgatisin llaçin (materialin lidhës) përkatës në raportin e duhur;
- të shtrojnë llaçin(materialin lidhës) e vendosin tullat në pikat orientuese në lidhje në formë"T" "L" dhe "+" (kryq);
- të kryejnë lidhjet e murit me strukturat e ndryshme sipas detajeve të gatshme;
- të ndërtojnë murin në lidhje në formë"T" "L" dhe "+" (kryq) duke respektuar spangot dhe kontrolluar me skuadër/gone këndet 90°dhe plumbçe vertikalitetin;
- të sigurojnë lidhjen e fugaturave midis rrjeshtave;
- të pastrojnë/përpunojnë fugaturat e llaçit(materialin lidhës);
- të ndërtojnë brezat dhe kollonetat b/a antisizmik në kuotën dhe largësinë e duhur sipas fletës së

projektit;
- të kryejnë dizarmimin e armaturës së dërrasës në
- kohën e duhur;
- të ndërtojnë/montojnë sipas rastit arkitrarët e dyerve dritareve sipas fletës së projektit;
- të shtrëngojnë muret në lidhjen në tavan sipas kushteve teknike;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë ndërtimit të murit me tulla të ndryshme në lidhje në formë “T” “L” dhe “+” (kryq);
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standartit;
- të pastrojnë, mirëmbajnë e sistemojnë vendin e mjetet e punës pas ndërtimit të murit me tulla të ndryshme në lidhje në formë “T” “L” dhe “+” (kryq);
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me tulla të ndryshme në lidhje në formë “T” “L” dhe “+” (kryq).

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 4 Nxënësit ndërtojnë mur me tulla xhami.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kryejnë piketimin me spango të mureve me tulla xhami;
- të përgatisin profilin metalik për vendosjen e tullave të xhamit;
- të përgatisin ngjitësin përkatës për ndërtimin e murit me tulla xhami;
- të shtrojne ngjitësin dhe vendosin profilin metalik;
- të vendosin tullat e xhamit të rradhës të parë në folenë e profilit metalik;
- të ndërtojnë murin me tulla xhami duke kontrolluar me instrumente matëse e niveluese;
- të pastrojnë sipërfaqen e murit me tulla xhami nga ngjitësi i tepërt;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të ndërtimit të murit me tulla xhami;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;

- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standartit;
- të pastrojnë mirëmbajnë e sistemojnë vendin e mjetet e punës pas ndërtimit të murit me tulla xhami**;**
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me tulla xhami;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 5 Nxënësit ndërtojnë mure me blloqe**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kryejnë nivelimin e bazës ku do të ndërtohet muri me blloqe(betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.);
- të kryejnë piketimin me spango të mureve me blloqe (betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.);
- të presin me vegla dore blloqet në ½ pjesë të tyre;
- të përgatisin llaçin (materialin lidhës) përkatës në raportin e duhur;
- të shtrojnë llaçin(materialin lidhës) e vendosin blloqet në dy skajet e murit për radhën e parë;
- të ndërtojnë murin me blloqe (betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.) duke lidhur fugaturat midis rrjeshtave;
- të kontrollojnë ndërtimin e murit me instrumentet matëse e niveluese;
- të ndërtojnë brezat dhe kollonetat b/a sipas fletës së projektit në kuotën dhe largësinë e duhur;
- të kryejnë dizarmimin e armaturës së dërrasës në kohën e duhur;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë ndërtimit të
- murit me blloqe (betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.);
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të pastrojnë, sistemojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas ndërtimit të murit me blloqe (betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.);
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me blloqe (betoni,beton-silikat,të lehtësuar etj.);

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 6 Nxënësit ndërtojnë detaje muresh me tulla të ndryshme (kanalet e ventilimit, paturë, pilastër, shtyllë)**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kryejnë piketimin me spango për ndërtimin e detajeve të mureve me tulla të ndryshme (kanalet e ventilimit/tymit, paturë,pilastër,shtyllë) etj;
- të përgatisin llaçin (materialin lidhës) përkatës sipas manualit të përdorimit;
- të vendosin shabllonin e gatshëm për kanalet e ventilimit/tymit, sipas skicës së dhënë.
- të shtrojnë llaçin(materialin lidhës) dhe vendosin tullat e rrjeshtit të parë përreth shablloneve për kanalet e ventilimit/tymit, sipas skicës së dhënë;
- të shtrojnë llaçin(materialin lidhës)e vendosin tullat e respektive të rrjeshtit të parë për paturë, pilastër e shtyllë;
- të ndërtojnë detajet e mureve me tulla të ndryshme (kanalet e ventilimit/tymit, paturë,pilastër,shtyllë), etj sipas fletës projektit;
- të sigurojnë lidhjen e fugaturave midis rrjeshtave;
- të realizojnë kontrollin gjatë ndërtimit të tyre me instrumente matëse e niveluese e pozicionin e aksit të murit;
- të heqin shabllonin nga kanalet e ventilimit/tymit në kohën e duhur;
- të pastrojnë/përpunojnë fugaturat e llaçit(materialin lidhës);
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të ndërtimit të detajeve të mureve me tulla të ndryshme (kanalet e ventilimit/tymit, paturë,pilastër,shtyllë)etj;;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standartit;
- të pastrojnë mirëmbajnë e sistemojnë vendin e mjetet e punës pas ndërtimit të detajeve të mureve me tulla të ndryshme (kanalet e ventilimit/tymit, paturë,pilastër,shtyllë) etj;
- të zbatojnë rregullat e higjenës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimin të detajeve të mureve me tulla të ndryshme (kanalet e ventilimit/tymit, paturë, pilastër, shtyllë) etj;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme, lidhje në formë “L”, “ T” dhe “ +”. dhe detajet e mureve me tulla ( kanalet e ventilimit, paturë, pilastër, shtyllë) si dhe muret me tulla xhami.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për analizimin, planifikimin organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore, përdorimin e drejtë të mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në detyra konkrete pune për ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme, lidhje në formë “L”, “ T” dhe “ +”. dhe detajet e mureve me tulla (kanalet e ventilimit/ tymit, paturë, pilastër, shtyllë) si dhe muret me tulla xhami duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit të mbikqyrur nga mësuesi i praktikës.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare në punimet për ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për veprimet parapërgatitore,përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme, lidhje në formë “L”, “ T” dhe “ +” dhe detajet e mureve me tulla( kanalet e ventilimit/tymit, paturë,pilastër,shtyllë) si dhe muret me tulla xhami. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,<br>– Pankarta me detaje të ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme, lidhje në formë “L”, “ T” dhe “ +”dhe detajet e mureve me tulla( kanalet e ventilimit/ tymit, paturë,pilastër,shtyllë) si dhe muret me tulla xhami e blloqe.<br>– Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.<br>– Kompleti i veshjes së punës.<br>– Tulla e blloqe të llojeve të ndryshme,llaç i gatshëm.<br>– Shabllon për kanalet e tymit,armaturë dërrase e hekuri të p/pergatitura për brezin antisizmik e kollonetat.<br>– Beton i gatshëm,distancatorë.<br>– Profilit metalik për tulla xhami ,lidhës për tulla xhami.<br>– Kompleti i veglave të muratorit.<br>– Skela të gatshme.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit për zbërthimin e kostos. |

**2. Moduli “Termoizolimi i mureve”**

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

<table>
<tr><th colspan="3">PËRSHKRUESI I MODULIT</th></tr>
<tr><td>Titulli dhe kodi</td><td>TERMOIZOLIMI I MUREVE</td><td>M-02-1820-22</td></tr>
<tr><td>Qëllimi i modulit</td><td colspan="2">Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e termoizolimit të mureve</td></tr>
<tr><td>Kohëzgjatja e modulit</td><td colspan="2">69 orë mësimore</td></tr>
<tr><td>Niveli i parapëlqyer Për pranim</td><td colspan="2">Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK .</td></tr>
<tr><td>Rezultatet e të mësuarit (RM) procedurat e vlerësimit</td><td colspan="2">RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.<br>Kriteret e vlerësimit:<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;<br>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet e elementeve të termoizilimit me aksesorët përkatës;<br>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e termoizolimit të mureve;<br>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare në punimet e termoizolimit të mureve;<br>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;<br>– të planifikojnë bazën materiale,mjetet,instrumentet dhe paisjet e punës sipas proçeseve të punës;<br>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve të termoizolimit të mureve;<br>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;<br>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;<br>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;<br>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e termoizolimit e mureve.<br>Instrumentet e vlerësimit:<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë<br><br>RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore<br>Kriteret e vlerësimit:<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;</td></tr>
</table>

- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e termoizolimit të mureve;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për punimet e termoizolimit të mureve;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës në punimet e termoizolimit të mureve;
- të shënojnë vendin për fiksimin e elementeve të aluminit sipas trashësisë së murit sipas detajit në projekt;
- të përgatisin elementet e aluminit me gjatësinë e duhur sipas skicës;
- të bëjnë matjet e shënojnë në fletët termoizoluese përmasat përkatëse sipas detajit të dhënë;
- të parapërgatisin fletët termoizoluese (poliesterol, lesh xhami,etj) sipas përmasave në skicën e dhënë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 3 Nxënësit kryejnë termoizolimin e mureve**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kontrollojnë nivelimin e bazës ku do të ndërtohet muri me shtresë termoizoluese duke përdorur instrumentet niveluese;
- të shtrojnë llaçin dhe ndërtojnë murin e parë perimetral deri në lartësinë 1,5 m, duke bërë lidhjen me fitilat e lëna në shtyllat prej betoni të armuar;
- të fiksojnë elementet e aluminit deri në kuotën e brezit antisizmik sipas skicës;
- të vendosin në mes të murit dopio, shtresën termoizoluese (polisterol /lesh xhami etj);
- të ndërtojnë murin e dytë perimetral deri në lartësinë 1,5 m, duke bërë lidhjen me fitilat e lënë në shtyllat prej betoni të armuar;
- të vendosin kallëpin e dërrasat kufizuese të niveluara për brezin antisizmik sipas skicës;
- të vendosin skeletin e hekurit të gatshëm për kollonetat dhe brezin antisizmik sipas skicës;
- të kryejnë betonimin e tyre me beton të gatshëm;
- të kryejnë dizarmimin e armaturës së dërrasës në kohën e duhur;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të termoizolimit të mureve;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;

| | |
|---|---|
| | – të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standartit;<br>– të pastrojnë mirëmbajnë e sistemojnë vendin e mjetet e punës pas punimeve të termoizolimit të mureve;<br>– të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;<br>– të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të termoizolimit të mureve;<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit .<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për termoizolimin e mureve dhe riparime të mundshme të tyre.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për analizimin, planifikimin e organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore, përdorimin e drejtë të mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në detyra konkrete pune për termoizolimin e mureve dhe riparime të mundshme të tyre duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit të mbikqyrur nga mësuesi i praktikës.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare në punimet e termoizolimit të mureve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës,kryerjen e veprimeve parapërgatitore,përdorimin e drejtë mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë termoizolimit të mureve si dhe riparimin e tyre duke respektuar rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.<br>– Pankarta me detaje të termoizolimit të mureve me materiale të ndryshme.<br>– Mjetet, kompleti i veglave e instrumentet matëse e niveluese.<br>– Kompleti i veshjes së punës.<br>– Skela të gatshme<br>– Materiale të ndryshme termoizolimi(poliesterol,lesh xhami etj.), elemente alumini bashkë me aksesorët e tij.<br>– Tulla të lehtësuara për mur dopio,llaç i gatshëm. |

| | |
|---|---|
| | – Armaturë dërrase e hekuri të p/pergatitura për brezin antisizmik e kollonetat.<br>– Beton i gatshëm,distancatorë.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 3. Moduli “Ndërtimi i mureve me gurë dhe buto-beton”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **NDËRTIMI I MUREVE ME GURË DHE BUTO-BETON** | **M-02-1821-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit në ndërtimin e mureve me gurë dhe buto-beton. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 84 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim” niveli II i KSHK. | |

| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;<br>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet për ndërtimin e mureve me gurë dhe buto-beton;<br>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për ndërtimin e mureve me gurë dhe buto-beton;<br>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për ndërtimin e mureve me gurë dhe buto-beton;<br>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;<br>– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proçeseve të punës;<br>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve në ndërtimin e mureve me gurë dhe buto-beton;<br>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;<br>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;<br>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;<br>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në ndërtimin e mureve me gurë dhe buto-beton;<br>***Instrumentet e vlerësimit:*** |
|---|---|---|

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelat në dy anët e murit të gurit ;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për ndërtimin e mureve me gurë e butobeton;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për ndërtimin e mureve me gurë e butobeton;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para ndërtimit të mureve me gurë e butobeton;
- të shënojnë pozicionin, akset e gjerësinë e mureve, sipas fletës projektit në modina;
- të kontrollojnë kuotën fillestare të murit të themelit, pozicionin e akset e gjerësinë e tyre, sipas modinave;
- të përpunojnë gurët natyrorë për ndërtimin e mureve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit ndërtojnë xokol e mur guri në lartësi.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të nivelojnë me llaç çimento murin e themelit ku do të ndërtohet xokoli;
- të kontrollojnë aksin dhe vendosin spangot drejtuese anësore të xokolit dhe murit me gurë sipas skicës;
- të përpunojnë gurët natyrorë për ndërtim xokoli e muri në lartësi sipas kushtit teknik;
- të ndërtojnë xokolin me gurë deri në kuotën e duhur dhe kontrollojnë me instrumente matëse e niveluese;
- të përpunojnë fugaturat e llaçit në kohën e duhur;
- të nivelojnë me llaç çimento xokolin ku do të ndërtohet muri i gurit;
- të përgatisin llaçin në raporin e duhur sipas tabelës;
- të shtrojnë llaçin e vendosin gurët kryesorë në pikat orientuese për formimin e kollonave prej guri;
- të ndërtojnë kollonat prej guri të mëdha duke respektuar këndin 90° sipas fletës projektit;
- të shtrojnë llaçin e vendosin gurët kryesorë në pikat orientuese për formimin e lidhjeve në formë “L”,”T” “+” të mureve prej guri;
- të ndërtojnë murin të drejtimeve pingule, duke

kontrolluar këndin 90°, sigurojnë lidhjen midis rrjeshtave sipas skicës;
- të ndërtojnë murin me gurë deri në lartësinë e brezave duke mbuluar e pastruar fugat dhe kontrolluar vertikalitetin e horizontalitetin e tyre;
- të ndërtojnë brezin horizontal b/a duke e lidhur me struktura të ndryshme sipas fletës projektit;
- të ndërtojnë qemeret e dyerve dhe dritareve duke përdorur teknika të ndryshme sipas detajeve të dhëna;
- të pastrojnë/përpunojë fugaturat e llaçit në kohën e duhur;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë ndërtimit të murit me gurë natyrorë;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e instrumentet e punës pas ndërtimit të murit me gurë;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me gurë.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 4 Nxënësit ndërtojnë mur buto-betoni**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:
- të kontrollojnë kuotën fillestare për ndërtimin e murit buto-beton;
- të shtrojnë shtresën e zhavorrit në bazament me trashësi 10 cm duke e ngjeshur;
- të ndërtojnë kallëpin dërrasës për ndërtimin e murit buto-beton sipas skicës së dhënë;
- të kryejnë kontrollin me instrumente matëse e niveluese duke përforcuar nga jashtë kallëpin;
- të mbushin kallëpin me 75-70% beton të gatshëm;
- të hedhin në brendësi të betonit 25-30% gurë natyror duke respektuar kushtet teknike të zbatimit;
- të realizojnë vibrimin e kallëpit me vegla dore sipas kushtet teknike të zbatimit;
- të nivelojnë murin buto-beton me vegla dore;
- të kryejnë mirmbajten në kohë e duhur të murit buto-beton sipas kushtet teknike të zbatimit;
- të heqin sipas radhës përforcuesit, binarët e kallëpin në kohën e duhur;
- të mbushin boshllëqet e transhesë me dhè e mbeturina në kohën e duhur duke i ngjeshur;

| | |
|---|---|
| | – të kryejnë riparime të mundshme gjatë ndërtimit të murit butobeton;<br>– të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;<br>– të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;<br>– të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e instrumentet e punës pas ndërtimit të murit butobeton;<br>– të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;<br>– të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit butobeton.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të ndërtimit të mureve me gurë e buto-beton.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin, planifikimin organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimin e mureve me gurë e buto-beton si dhe për ndërtimin e mureve me gurë e buto-beton duke përdorur drejt mjetet dhe instrumentet matëse e niveluese.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për detyra administrative dhe tregtare në ndërtimet e mureve me gurë e buto-beton.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë ndërtimit të mureve me gurë e buto-beton.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës,kryerjen e veprimeve parapërgatitore,përdorimin e drejtë të mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë ndërtimit të mureve me gurë dhe buto-beton si dhe riparimin e tyre duke respektuar rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes së mjedisit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.<br>– Pankarta me detaje të ndryshme të ndërtimit të mureve me |

| | |
|---|---|
| | gurë e buto-beton.<br>– Mjetet, kompleti i veglave e instrumentet matëse e niveluese.<br>– Kompleti i veshjes së punës.<br>– Skela të gatshme,rrjeta mbrojtëse.<br>– Gurë natyrorë,llaç çimento e të përzier,distancatorë.<br>– Armaturë dërrase e hekuri të p/përgatitura për brezin antisizmik.<br>– Beton i gatshëm për ndërtim muri buto-beton dhe brezin antisizmik.<br>– Armaturë dërrase të p/përgatitura për ndërtim muri buto-beton,përforcuesit e tyre.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit.<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |





## 4. Moduli “Suvatime të brendshme e të jashtme”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **SUVATIME TË BRENDSHME E TË JASHTME** | **M-02-1822-22** |

| | |
|---|---|
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për realizimin e suvatimeve në mjediset e brendshme (tavane, mure dhe shpatulla të dyer-dritareve) dhe të jashtme (fasada,etj.). |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 102 orë mësimore |
| **Niveli i parapëlqyer Për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK. |

**Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1** **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**

*Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;
- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe llojet e mënyrat e ndryshme të suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;
- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe pajisjet e punës sipas proçeseve të punës;
- të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve në kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të ndajnë detyrat sipas grafikut të punimeve në kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 2** **Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.**

*Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën dhe rrjetën mbrojtëse;

- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për kryerjen e suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para kryerjes së suvatimeve të brendshme e të jashtme;
- të kontrollojnë rrafshtësinë e sipërfaqeve me instrumentet e kontrollit;
- të riparojnë defektet e mundshme të sipërfaqeve para suvatimeve të brendshme e të jashtme, duke respektuar kushtet teknike të zbatimit;
- të pastrojnë/lajnë fasadat, tavanet dhe muret nga pluhurat e mbetjet e ndryshme.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit spërkatin me spruco sipërfaqet dhe formojnë drejtuesit (fashaturat).**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përziejnë me krahë/makineri llaçin e çimentos(sprucon) sipas kërkesave teknike në raportin e duhur;
- të spërkatin me spruco sipërfaqet e brendshme e të jashtme të ndërtesës me krahë/ makineri.
- të vendosin këndoret metalike të gatshme në çdo kënd të mundshëm;
- të stukojnë rrjetat e gatshme lidhëse(mbrojtjen e plasaritjeve) në vendet midis elementeve mur-kollonë etj.sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të fiksojnë takot e gatshme për fashaturat niveluese duke kontrolluar me instrumente matëse e niveluese;
- të mbushin hapësirat midis takove me fashatura të gatshme duke kontrolluar me mastar-nivelë;
- të mbushin hapësirat midis takove me llaç duke duke kontrolluar me mastar-nivelë;
- të presin me mastar llaçin e tepërt të fashaturave midis takove duke respektuar kohën e duhur;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të shtresës së parë të suvatimeve të brendshme e të jashtme ;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas realizimit të punimeve të shtresës së parë të suvatimeve të brendshme e të jashtme**;**
- të zbatojnë rregullat e higjenës personale në punë;

- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të shtresës së parë  të suvatimeve të brendshme e të jashtme;.

***Instrumentet e vlerësimit*:**
- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 4 Nxënësit realizojnë shtresën e dytë të suvatimit**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:
- të përgatisin llaçin e përzier me makineri në raportin e duhur të përbërësve të tij (lidhës-mbushës-ujë);
- të realizojnë me llaçin e përzier, suvatimin e shtresës së dytë (mbushja) midis fashaturave;
- të presin me mastar në kohën e duhur llaçin e tepërt duke u bazuar në fashaturat;
- të vendosin dhe fiksojnë me ganxha mastarët kufizues të niveluar (ose profilet) me mastar-nivelë vertikalisht ose horizontalisht në këndin 90°**;**
- të hedhin shtresën e dytë të suvatimit të shpatullave të dyer-dritareve (ose këndeve të mureve) me vegla dore duke kontrolluar me mastar-nivelë vertikalisht ose horizontalisht dhe me skuadër këndin 90°**;**
- të heqin ganxhat nga mastarët e shpatullave të dyer-dritareve pas ngurtësimit të llaçit;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të shtresës së dytë të suvatimeve të brendshme e të jashtme ;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas realizimit të shtresës së dytë të suvatimeve të brendshme e të jashtme**;**
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të shtresës së dytë të suvatimeve të brendshme e të jashtme;.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 5 Nxënësit realizojnë shtresën e tretë të suvatimit (finon).**

***Kriteret e vlerësimit*:**

Nxënësit duhet të jenë të aftë:
- të përziejnë me ujë, finon e gatshme deri në konsistencën e duhur;
- të lagin sipërfaqen e brendshme e të jashtme para hedhjes së finos;
- të hedhin finon në sipërfaqe me vegla dore dhe ta

| | |
|---|---|
| | shpërndajnë me një shtresë të hollë;<br>– të fërkojnë finon me vegla dore, sipas kushteve teknike të zbatimit;<br>– të kryejnë riparime të mundshme gjatë suvatimit të dorës së tretë (fino);<br>– të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;<br>– të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;<br>– të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë veglat, mjetet e vendin e punës pas realizimit të shtresës së tretë të suvatimit (finos);<br>– të zbatojnë rregullat e higjenës personale në punë;<br>– të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë suvatimit të dorës së tretë (fino).<br>***Instrumentet e vlerësimit*:**<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të suvatimeve të brendshme e të jashtme.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për analizimin, planifikimin dhe organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore për suvatime të brendshme e të jashtme.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në detyra konkrete për realizimin e shtresave të suvasë së brendshme e të jashtme(fasadat) si dhe suvatimet e shpatullave të dyer-dritareve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare për në realizimin e suvatimeve të brendshme e të jashtme (fasadat).<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të parapërgatitjes së mjeteve e materialeve të punës për realizimin e suvatimeve të brendshme të jashtme (fasadat), suvatimeve të shpatullave të dyer-dritareve, si dhe riparimin e tyre. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit. |

- Pankarta me detaje dhe lloje të shtresave të suvatimeve.
- Mjetet, kompleti i veglave e instrumentet matëse e niveluese për suvatime.
- Kompleti i veshjes së punës, skela të gatshme,rrjeta mbrojtëse.
- Betonjerë,pompë suvatimi,përzierës fino.
- Materialet për suvatim:
- Rërë e larë me granulometri të ndryshme.
- Fino e gatshme, stuko, çimento, ujë.
- Këndorë të gatshëm,tako,fashatura të gatshme.
- Rrjeta lidhëse
- Pajisje kancelarie.
- Manualet e preventivimit për zbërthimin e kostos.
- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit.
- Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal.

## 5. Moduli “Ndërtimi i mureve me gurë në të thatë”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **NDËRTIMI I MUREVE ME GURË NË TË THATË** | **M-02-1823-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për ndërtimin e mureve me gurë në të thatë | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer Për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK. | |

**Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1** **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:
- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;
- të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet për ndërtimin e mureve në të thatë;
- të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për ndërtimin e mureve në të thatë;
- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për ndërtimin e mureve në të thatë;
- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;
- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës sipas proçeseve të punës;
- të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve në ndërtimin e mureve në të thatë;
- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;
- të plotësojnë dokumentacionin teknik;
- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;
- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në ndërtimin e mureve në të thatë;

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 2** **Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e ndërtimit të mureve në të thatë;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për punimet e ndërtimit të mureve në të thatë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para ndërtimit të mureve në të thatë e gabiona;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit ndërtojnë mure me gurë në të thatë dhe gabiona.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të piketojnë me spango gjerësinë e murit me gurë në të thatë sipas skicës së dhënë;
- të thellojnë tokën dhe heqin dheun për ndërtimit të murit me gurë në të thatë;
- të vendosin gurët në rrjeshtin e parë duke i ngjeshur fort me tokën;
- të mbushin me dhe dhe mbeturina rrethanore boshllëqet midis gurëve;
- të ndërtojnë murin me gurë në të thatë deri në lartësinë e lejuar sipas kushteve teknike;
- të ndërtojnë skeletin e gabionave : koshat me rrjetën metalike antikorrezive me shufra çeliku të mprehta sipas detajit të fletës projektit;
- të fusin në tokë kunjat e çelikut të mprehta të gabioneve
- të mbushin koshin e rrjetës me gurë të thatë duke respektuar përmasat e gurëve dhe mbuluar fugat;
- të lidhin gabionat midis tyre dhe me terrenin me spirale metalike, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë veglat, mjetet e vendin e punës pas realizimit të ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona.

| | |
|---|---|
| | ***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në analizimin, planifikimin dhe organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona si dhe për përdorimin e mjeteve e makinerive dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare në punimet e ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe të mirëmbajtjes së mjeteve e makinerive dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona, të përdorimit të mjeteve e makinerive të punës, për realizimn e ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona si dhe riparimin e tyre. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.<br>– Pankarta me detaje të ndryshme të ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona.<br>– Mjetet, kompleti i veglave e instrumentet matëse e niveluese për ndërtimit të murit me gurë në të thatë e gabiona.<br>– Kompleti i veshjes së punës, skela të gatshme.<br>– Gurë natyrorë të madhësive të ndryshme,zhavorr.<br>– Koshat me rrjetën metalike antikorrezive për gabiona.<br>– Shufra/kunja çeliku të mprehta të gatshme.<br>– Spirale metalike për lidhje gabionash.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit për koston e punimeve.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit.<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Ndërtimi i mureve dekorativë”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | | |
|---|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **NDËRTIMI I MUREVE DEKORATIVË** | | **M-02-1824-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit në ndërtimin e mureve dekorativë. | | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim” niveli II i KSHK. | | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;<br>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e mureve dekorativë e elementeve me aksesorët përkatës të tyre;<br>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e mureve dekorative;<br>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare në ndërtimin e mureve dekorative;<br>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;<br>– të planifikojnë bazën materiale,mjetet,instrumentet dhe paisjet e punës sipas proçeseve të punës;<br>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve në ndërtimin e mureve dekorative;<br>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;<br>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;<br>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;<br>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e ndërtimit të mureve dekorativë.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë | |

**RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për ndërtimet e mureve dekorative;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për punimet e mureve dekorative;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës në punime e mureve dekorative;
- të shënojnë koordinatat dhe kuotat e konstruksionit të murit dekorativ sipas fletës projektit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit ndërtojnë mure dekorative**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kontrollojnë nivelimin e bazës ku do të ndërtohet muri dekorativ me panele rigipsi me instrumentet matëse e niveluese;
- të përcaktojnë e shënojnë pozicionin e rrafshit vertikal të murit me instrumentet përkatëse sipas skicës;
- të montojnë profilet metalike për skeletin e murit sipas skicës;
- të montojnë panelet e rigipsit në njërën faqe të skeletit metalik të murit duke përdorur aksesorët përkatës;
- të vendosin materialin termoizolues dhe ta fiksojnë atë në skeletin metalik të murit duke përdorur aksesorët përkatës;
- të montojnë panelet e rigipsit në faqen tjetër të skeletit metalik të murit duke përdorur aksesorët përkatës;
- të mbulojnë me rrjeta mbrojtëse dhe stukojnë fugat midis paneleve të rigipsit duke përdorur materialet përkatëse;
- të kryejnë hapjen e vrimave për instalimet e kutive elektrike etj;
- të fiksojnë këndoret e gatshme sipas kushteve teknike;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë ndërtimit të murit dekorativ;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës sipas fletës projektit;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;

| | |
|---|---|
| | – të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas ndërtimit të murit dekorativ;<br>– të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;<br>– të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit dekorativ.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për ndërtimin e mureve dekorativë.<br>– Nxënësit duhet të analizojnë , planifikojnë dhe kryejnë organizimin e vogël të punës,të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimin e mureve dekorative si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë ndërtimit të mureve dekorativë.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare në punimet e ndërtimit të mureve dekorativë.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimin e mureve dekorative, përdorimit të dretë të mjeteve të punës, të ndërtimit të mureve dekorativë sipas projektit si dhe riparimin e tyre. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.<br>– Pankarta me detaje të ndryshme të mureve dekorative<br>– Skela të gatshme.<br>– Kompleti i punës dhe i veglave e instrumenteve.<br>– Panele rigipsi,rrjeta mbrojtëse, stuko,këndorë të gatshëm.<br>– Profilet metalike,material termoizolues dhe aksesorët e tij<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit për koston e punimeve.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit.<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 2. Moduli “Ndërtimi i mureve mbajtëse në rrugë”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **NDËRTIMI I MUREVE MBAJTËSE NË RRUGË** | **M-02-1825-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit në ndërtimin e mureve mbajtëse në rrugë | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;<br>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e ndtyshme për ndërtimet e mureve mbajtëse në rrugë;<br>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për ndërtimet e mureve mbajtëse në rrugë;<br>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare për ndërtimet e mureve mbajtëse në rrugë;<br>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;<br>– të planifikojnë bazën materiale,mjetet,instrumentet dhe paisjet e punës sipas proçeseve të punës;<br>– të përcaktojnë radhën e kryerjes në punimet ndërtimet e mureve mbajtëse në rrugë;<br>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;<br>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;<br>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;<br>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen ndërtimet të mureve mbajtëse në rrugë.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë<br><br>**RM 2** **Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë: | |

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë;
- të sigurojnë furnizimin me ujë dhe rrymë elektrike;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për ndërtimin e mureve mbajtëse në rrugë;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para punimeve të ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë;
- të kontrollojnë/ piketojnë kuotën,gjerësinë e tabanit të bazës ku do të ndërtohet muri mbajtës dhe aksin e tij duke parë në modinat.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit ndërtojnë mure mbajtëse në rrugë**

***Kriteret e vlerësimit*:**

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të piketojnë me spango gjerësinë e muri mbajtës sipas skicës së dhënë;
- të punojnë dhe të thellojnë tokën para fillimit të ndërtimit të murit;
- të shtrojnë shtresën e zhavorrit për filtrimin e ujrave;
- të shtrojnë llaçin dhe vendosin gurët kryesorë në këndet e murit duke respektuar drejtimin e spangove dhe kuotat e terrenit;
- të ndërtojnë murin mbajtës dhe mbushin boshllëqet me gurë të vegjël midis gurëve lidhës;
- të realizojnë vrimat ose vendosin tubat në pozicionet e dhëna në projekt për depërtimin e ujërave të larta gjatë ndërtimit të murit mbajtës;
- të ndërtojnë brezin rrafshues 15-20 cm me beton sipas fletës projektit;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të sistemojnë,pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë**;**
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

– Pyetje-përgjigje me gojë

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë.<br>– Nxënësit duhet të analizojnë , planifikojnë dhe kryejnë organizimin e vogël të punës,të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimin e mureve mbajtëse në rrugë si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare në punimet e ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë me gurë, si dhe riparimin e tyre. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi.<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.<br>– Pankarta me detaje të ndryshme të ndërtimit të mureve mbajtëse në rrugë.<br>– Skela të gatshme.<br>– Mjetet,veglat e instrumentet matëse e niveluese.<br>– Kompleti i veshjes së punës.<br>– Materialet për muraturë guri mbajtës:<br>– Gurë natyrorë,zhavorr,llaç i gatshëm.<br>– Tuba drenazhimi,beton e kallëp i gatshëm për brezin.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit për koston e punimeve<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 3. Moduli “Ndërtimi i qemerëve me tulla”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **NDËRTIMI I QEMERËVE ME TULLA** | **M-02-1826-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit në kryerjen e detyrave të punës për ndërtimin e qemerëve me tulla. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK. | |

**Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1** **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**

*Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;
- të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e llojet e qemerëve me tulla;
- të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e qemerëve me tulla;
- të kryejnë detyra administrative dhe tregtare në
- punimet e qemerëve me tulla;
- të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;
- të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe pajisjet e punës sipas proceseve të punës
- të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve të qemerëve me tulla;
- të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;
- të plotësojnë dokumentacionin teknik;
- të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;
- të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të qemerëve me tulla.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e qemerëve me tulla;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për punimet e qemerëve me tulla;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para punimeve të qemerëve me tulla;
- të kontrollojnë kuotën ku do të ndërtohet qemeri me tulla, duke përdorur instrumentet matëse e niveluese
- të fiksojnë skelat e varura për vendojen e shabllonit;
- të parapërgatisin shabllonin e qemerit sipas përmasave e skicës së dhënë;
- të pastrojnë e sistemojnë vendin e punës para kryerjes së ndërtimit të qemerëve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 3 Nxënësit ndërtojnë qemerët me tulla.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të vendosin shabllonin e qemerit hark/sheshtë mbi skelat e varura duke respektuar kuotat sipas skicës;
- të fiksojnë përfundimisht skelën e varur në bazë të kuotës së dhënë;
- të përgatisin materialin lidhës(llaç) për ndërtimin e qemerit;
- të vendosin tullat pykë në shabllon duke i lidhur me llaç sipas spangos-rreze të harkut të qemerit apo të sheshtë;
- të ndërtojnë qemerët me tulla sipas fletës projektit ;
- të kontrollojnë ndërtimin e tyre me instrumenete matëse e niveluese
- të heqin skelat e varura e shabllonin në kohën e duhur;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimeve të qemerëve me tulla;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
- të sistemojnë, pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas realizimit të punimeve të qemerëve me tulla**;**
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;

| | |
|---|---|
| | – të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të qemerëve me tulla;<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt dhe repartin e ndërtimit.<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për ndërtimin e qemerëve me tulla.<br>– Nxënësit duhet të analizojnë, planifikojnë dhe kryejnë organizimin e vogël të punës, angazhohen për kryerjen e veprimeve parapërgatitore për ndërtimin e qemerëve me tulla, si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare lidhur me punimet e qemerëve me tulla.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese në ndërtimin e qemerëve me tulla .<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për për parapërgatitjen dhe realizimn e ndërtimit të qemerëve me tulla, si dhe riparimin e tyre. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi.<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune,akte kontrolli,projekt zbatimi, detaje,skica,udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit, pankarta për ndërtimin e qemerëve me tulla.<br>– Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.<br>– Kompleti i veshjes dhe veglave të punës.<br>– Materialet për muraturë: tulla të plota,spango,llaç të gatshëm<br>– Skela të varura të gatshme.<br>– Shabllone të gatshme.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Manualet e preventivimit për koston e punimeve.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit.<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 4. Moduli “Suvatime dekorative ”

**Drejtimi:** **Ndërtim**
**Profili:** **Muratim dhe suvatim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **SUVATIME DEKORATIVE** | **M-02-1827-22** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e suvatimeve të ndryshme dekorative. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;<br>– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e shtresave të suvatimeve dekorativë dhe përbërësit përkatës të tyre;<br>– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për suvatimet dekorative;<br>– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare në punimet e suvatimeve dekorative;<br>– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;<br>– të planifikojnë bazën materiale,mjetet,instrumentet dhe paisjet e punës sipas proçeseve të punës;<br>– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve gjatë suvatimeve dekorative;<br>– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;<br>– të plotësojnë dokumentacionin teknik;<br>– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;<br>– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të suvatimeve dekorative.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br>– Pyetje-përgjigje me gojë |

**RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet e suvatimeve dekorative;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të mbulojnë pjesën tjetër të ndërtimit nga dëmtimet/papastërtitë që vijnë nga punimet;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për suvatimet dekorative;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës para kryerjes së suvatimeve dekorative;
- të kontrollojnë rrafshtësinë e sipërfaqeve me instrumentet e kontrollit;
- të bëjnë matjet e shënojnë në sipërfaqe fillimin e punimeve sipas detajit të dhënë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 3 Nxënësit kryejnë suvatime dekorative.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të pastrojnë sipërfaqen që do kryhet suvatimi dekorativ;
- të përpunojnë sipërfaqen me zmerilues dhe heqin pluhurat me respirator;
- të stukojnë çarjet apo dëmtimet eventuale sipas kushteve teknike;
- të kryejnë suvanë niveluese sipas kushteve teknike;
- të lyejnë me prajmer (2 duar)sipërfaqen për ngjitjen sa më mirë të suvatimit dekorativ;
- të përgatisin suvanë dekorative sipas llojit të materialit të murit;
- të shtrojnë në sipërfaqet suvanë dekorative në trashësinë e duhur;
- të përpunojnë në gjithë sipërfaqen suvanë dekorative të shtruar duke respektuar afatin kohor;
- të rrokullisim rulin dekorativ respektiv sipër suvasë dekorative brenda afatit kohor të përcaktuar;
- të realizojnë konfiguracione të ndryshme me shabllone në sipërfaqen e suvasë dekorative sipas fletës projektit;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë realizimit të suvasë dekorative;
- të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
- të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;

| | |
|---|---|
| | – të sistemojnë ,pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas realizimit të suvasë dekorative**;**<br>– të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;<br>– të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të suvasë dekorative;<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Pyetje-përgjigje me gojë<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.<br>– Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të suvatimeve dekorative.<br>– Nxënësit duhet të analizojnë , planifikojnë dhe kryejnë organizimin e vogël të punës, angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve parapërgatitore për suvatimeve dekorative, si dhe përdorimin e instrumenteve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për detyra administrative dhe tregtare lidhur me punimet e suvatimeve dekorative.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese gjatë suvatimeve dekorative.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e suvatimeve dekorative si dhe riparimin e tyre. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Objekt ndërtimi dhe mjedis pune ndërtimi.<br>– Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.<br>– Pankarta për suvatimet të ndryshme dekorative dhe detajet e shtresave të tyre.<br>– Material suvaje dekorative,primer,astar,aspirator,furçë pastrimi,përzierës stukoje, shpatulla plasike e metalike, sfungjer, rula dekorativ të llojeve të ndryshme, mistri me majë, malla me vrima dekorative, kovë.<br>– Mjetet, instrumentet matëse e niveluese<br>– Kompleti i veshjes së punës, skela të gatshme të lëvizshme<br>– Shabllone të gatshme<br>– Pajisje kancelarie, manualet e preventivimit për koston e punimeve, përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |